

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6360
E shtunë, 10 korrik 2021
çmimi 0.40 €

Specialja nuk jep arsye për moslejimin e Veselit në ceremoninë e varrimit të babait të tij **FAQE 5**



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

OPOZITA NUK I NDAL KRITIKAT NDAJ QEVERISË KURTI **FAQE 4**

OPOZITA AKUZON PUSHTETIN PËR KAPJEN E INSTITUCIONEVE TË PAVARURA



Partitë opozitare e kanë akuzuar qeverinë Kurti për kapje të institucioneve të pavarura. Zyrtarët e PDK-së, të AAK-së dhe të Nismës kanë thënë se me këto veprime qeveria në mënyrë arbitrare është duke i devalvuar institucionet publike dhe organet e pavarura. Ata kanë bërë me dije se do t'i kundërvihen me çdo mjet demokratik dhe ligjor kësaj mësymje arbitrare të pushtetit ndaj institucioneve të pavarura

AKTUALE



SOT ÇLIRIMTARËT DO TË DUHËJ TË ISHIN PRANË NESH DHE UDHËHEQËS TË DIALOGUT **F. 7**

Shkruan: Besa ISMAILI

FAMILJA BYTYÇI: SHBA-ja TË ANGAZHONET PËR ZBARDHJEN E VRASJES SË VËLLEZËRVE BYTYÇI **F. 31**

MASHTI SYNON QË PREJ SHTATORIT PROCESI MËSIMOR TË FILLOJË NË KUSHTE NORMALE **F. 6**

KRYETARI I GJYKATËS SË APELIT: PA RITJE TË NUMRIT TË GJYQARËVE S'MUND TË KETË EFIKASITET **F. 6**

EKONOMI

ATK-ja ARRIN QË PËR 74.3 MILIONË EURO TA RRIË INKASIMIN E TË HYRAVE NGA TATIMET **F. 8**

NUK MIRATOHET NË KOMISION PROJEKTLIGJI PËR AUTOMJETE **F. 8**

F. 8

KRASNIQI: BE-JA DUHET TA PËRMBUSHË PREMTIMIN KARSHI QYTETARËVE TË KOSOVËS **FAQE 5**



KURTI PËRSËRIT KËRKESËN QË GREQIA TA NJOHË KOSOVËN **FAQE 3**

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht--Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

“Pfizer” do të kërkojë autorizim për dozën e tretë të vaksinës

NJU-JORK, 9 KORRIK - Kompanitë “Pfizer” dhe “BioNTech” kanë njoftuar se do të kërkojnë autorizimin për një dozë të tretë të vaksinës së tyre kundër Covid-19. Sipas prodhuesit të vaksinave, një dozë e tretë brenda 12 muajsh do ta rrisë shumë imunitetin dhe, mbase, mund të ndihmojë për mbrojtje nga variantet e reja të koronavirusit.

Varianti “Delta” i koronavirusit ka ngjallur shqetësim në gjithë botën për shkak të aftësisë së përhapjes. “Pfizer” dhe “BioNTech” kanë theksuar se presin që një dozë e tretë do të jetë efektive kundër variantit “Delta” dhe se ata do të kërkojnë autorizim në Shtetet e Bashkuara, Evropë dhe rajone të tjera në javë e ardhshme.

Vaksina e “Pfizer”-it deri më tash merret dy doza. Hulumtimet e shumë vendeve tregojnë se vaksina e “Pfizer” dhe të tjerat ofrojnë mbrojtje të fortë kundër variantit shumë ngjithës “Delta”, i



cili po përhapet me shpejtësi në të gjithë botën dhe tani mbizotëron në shumicën e rasteve në Shtetet e Bashkuara. Por, antitruapat natyrshëm zbehen me kalimin e kohës, kështu që po zhvillohen studime nëse ka nevojë dhe kur do të duhet të merret një dozë e tretë. Të enjten Mikael Dolsten nga kompania “Pfizer” ka thënë për “Associated Press” se në disa

hulumtime të hershme rezultojnë se përmes një doze të tretë nivelet e antitropave të njerëzve ngritën 5-10 herë më shumë, krahasuar me dozën e dytë.

“Pfizer” ka në plan që në muajin gusht të kërkojë nga Administrata e Ushqimit dhe Barnave e ShBA-së autorizimin emergjent të një doze të tretë”, ka thënë ai.

Disa orë pasi “Pfizer” ka bërë

njoftimin, Administrata e Ushqimit dhe e Barnave e ShBA-së dhe qendrat për kontrollin e sëmundjeve kanë lëshuar një deklaratë të përbashkët në të cilën thuhej se amerikanët nuk kanë nevojë për një dozë të tretë të vaksinës, transmeton “CNN”. “Tash për tash amerikanët, të cilët janë të vaksinuar plotësisht, nuk kanë nevojë për një dozë përforcuese”, kanë thënë këto institucione.

Zyrtarët e qeverisë amerikane në vazhdimësi kanë thënë se ekziston një rrezik i ulët i infektimit për njerëzit e vaksinuar plotësisht, madje edhe nga varianti “Delta”.

Ky variant ka shkaktuar shpërthime të rasteve të reja të të infektuarve në Azi, Afrikë, ndërsa në Evropë dhe Shtetet e Bashkuara është shënuar rritje e numrit të rasteve të reja.

Ky variant fillimisht është zbuluar në Indi disa muaj më parë.

Revista “Nature” ka publikuar të

dhënat që tregojnë se, bazuar në testet laboratorike të dhjetëra njerëzve, pasi kanë marrë dozën e parë të vaksinave “Pfizer” ose “AstraZeneca”, imuniteti i tyre “mezi e frenoi” variantin “Delta”. Por, disa javë pasi morën dozën e dytë, pothuajse të gjithë kishin atë që studiuesit e konsideruan një rritje të imunitetit mjaft të fortë për të neutralizuar variantin “Delta”.

Më 6 korrik Izraeli ka njoftuar se efektiviteti i vaksinës “Pfizer/BioNtech” ka rënë pavarësisht se ajo mbetet shumë efektive për parandalimin e simptomave të rënda të sëmundjes Covid-19.

Ministria e Shëndetësisë e Izraelit tha se efektiviteti i vaksinës për parandalimin e infektimit dhe të sëmundjes me simptoma ka rënë në 64 për qind, por ajo mbetet 93 për qind efektive për parandalimin e hospitalizimeve dhe simptomave të rënda të sëmundjes.

Ligjvënësit evropianë bëjnë thirrje për më shumë sanksione ndaj Kinës

STRASBURG, 9 KORRIK - Ligjvënësit evropianë u kanë bërë thirrje zyrtarëve të Bashkimit Evropian (BE) t'i bojkotojnë Lojërat Olimpikë Dimërore të Pekinit 2022 në rast se Kina nuk angazhohet për përmirësimin e të drejtave të njeriut në Hong-Kong dhe për pakicën myslimane ujgure. Parlamenti Evropian ka miratuar një rezolutë e cila kërkon nga zyrtarët e institucioneve të BE-së dhe të shteteve anëtare “t'i refuzojnë ftesat për të marrë pjesë në Lojërat Olimpikë Dimërore të Pekinit 2022 nëse qeveria kineze nuk demonstroi përmirësim në situatën e të drejtave të njeriut”. Rezoluta kishte mbështetjen e të gjitha grupeve kryesore politike.

Eurodeputetët kanë theksuar “nevojën që BE-ja të ndërmerë veprime urgjente dhe të vendosura” dhe i bënë thirrje Brukselit të hartojë një valë të re sanksionesh kundër autoriteteve kineze.

Zyra e Komisionarit të Kinës në Hong-Kong kritikoi votimin duke thënë se ai është “një pengesë për bashkëpunimin midis Kinës dhe BE-së”.

Kina ka miratuar një ligj të ri të sigurisë për Hong-Kongun përmes të cilit ka arrestuar protestues pro-demokracisë dhe zëra kritikë në rajon.

Ligji, që është kritikuar ndërkombëtarisht, i kthen në vepra penale thirrjet për shpërthime të territorit, terrorizmin, bashkëpunimin me forcat e huaja dhe përfshin edhe ndëshkimin për burgim



të përjetshëm.

Autoritetet në Pekin dhe Hong-Kong kanë thënë se legjislativi ka qenë i nevojshëm për të sjellë stabilitet, por kritikët besojnë se ai synon të heshtë disidentët.

Hong-Kongu është pjesë e Kinës, mirëpo funksionon

sipas organizimit “një shtet, dy sisteme”, çka nënkupton se ky qytet ka sistemin e vet ligjor dhe të drejtat, që përfshijnë atë për liri të shprehjes dhe liri të shtypit.

Kohët e fundit, Kina po përballet me kritika dhe sanksione ndërkombëtare për ndalimin e më shumë se 1

milione ujgure dhe pakicave tjera myslimane në rajonin e Ksinjiangut.

Shtetet e Bashkuara e kanë përdorur termin gjenocid në përshkrimin e ngjarjeve atje. Sipas Kombeve të Bashkuara, të paktën 1 milion pjesëtarë të këtyre grupeve etnike janë arrestuar dhe janë dërguar në qendra të mbajtjes.

Kina ka theksuar se ato janë “qendra kundër-ekstremizmit” dhe shërbejnë si objekte të “arsimit profesional” që synojnë t'i ndihmojnë njerëzit të largohen nga terrorizmi dhe t'i lejojnë ata të riintegrohen në shoqëri. Por, komuniteti ndërkombëtar ka thënë se në ato kampe këta njerëz bëjnë “punë të detyruar” dhe trajtohen në mënyrë çnjerëzore.

Një skuadër e huaj e vrau presidentin, thotë Policia e Haitit

PORT-AU-PRINCE, 9 KORRIK - Një grup i përbërë nga 26 kolumbianë dhe dy amerikanë të Haitit qëndron pas vrasjes së presidentit të Haitit, Jovenel Moise, ka thënë policia haitiane. Presidenti Moise, 53 vjeç, është qëlluar për vdekje në shtëpinë e tij në Port-au-Prince, ndërsa gruaja e tij u plagos nga një grup, për të cilin zyrtarët thanë se e përbënin mercenarët.

“Në vendin tonë erdhën të huajt dhe e vranë presidentin”, ka thënë shefi i policisë, Leon Charles, në një konferencë për media. Ai ka konfirmuar se nga ai grup, 15 kolumbianë dhe amerikanë haitianë janë arrestuar, ndërsa tre nga sulmuesit janë vrarë. Tetë të tjerë janë ende në arrati.

Sipas një hetimi fillestar, disa nga vrasësit ishin ish-anëtarë të

ushtisë kolumbiane, tha ministri kolumbian i Mbrojtjes, Diego Molano.

Zyrtarët ende nuk kanë dhënë ndonjë motiv për vrasjen apo se kush e ka dhënë urdhrin. Ekzistojnë edhe dilema për faktin se pse nuk arritën ta mbrojnë presidentin pjesëtarët e sigurisë. Vdekja e Moise ka zhytur kombin e varfër në trazira.

Haiti veçse ishte në krizë politike,

madje edhe para se Moise ta merrte detyrën më 2017. Që nga zgjedhja e tij vendi është përballur me protesta të vazhdueshme.

Ai kishte qeverisur vendin përmes një dekreti pasi administrata e tij dështoi t'i mbajë zgjedhjet e përgjithshme në tetor të 2019-s. Vendi nuk ka një parlament të zgjedhur. Kryeministri i përkohshëm,



Claude Joseph, ka shpallur gjendje të emergjencës duke bërë me dije se ai tash është në udhëheqje të vendit. Zgjedhjet e reja presidenciale dhe parlamentare janë planifikuar për 26 shtator.

Kurti përsërit kërkesën që Greqia ta njohë Kosovën

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka kërkuar përsëri nga Greqia që ta njohë Republikën e Kosovës. Në ditën e dytë të edicionit të 25-të të tryezës së organizuar nga magazina prestigjioze britanike "The Economist", ai ka deklaruar që Greqia duhet t'u bashkohet 22 vendeve anëtare të BE-së që e kanë njohur Kosovën

"Epoka e re"

PRISHTINË, 8 KORRIK - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka përsëritur kërkesën që Greqia t'u bashkohet vendeve të BE-së që e kanë njohur Kosovën. Në ditën e dytë të edicionit të 25-të të tryezës së organizuar nga magazina prestigjioze britanike "The Economist", në bashkëpunim me qeverinë greke, Kurti ka thënë se njohja e Kosovës nga Greqi, bashkëpunimi në rajon dhe përfshirja sa më e shpejtë e rajonit në Bashkimin Evropian, është rruga e duhur drejt paqes, stabilitetit dhe sigurisë afatgjatë. Në panelin e diskutimit me temë "Evropa Juglindore: rritja e bashkëpunimit dhe solidaritetit", kryeministri Kurti ka deklaruar se 22 nga 27 shtetet anëtare të BE-së tashmë e kanë njohur

Republikën e Kosovës. Gjatë fjalës së tij, kryeministri Kurti ka folur për menaxhimin e pandemisë gjatë dy qeverive të udhëhequra nga ai. "Në qeverinë Kurti 1 Kosova ishte vlerësuar si një nga vendet me menaxhimin më të suksesshëm të pandemisë, kurse brenda 100 ditëve të qeverisë aktuale numri i rasteve aktive ka rënë nga 13 mijë në 170 sosh, teksa rastet e hospitalizuar kanë rënë nga 750 në 25. Brenda 66 ditëve të para të qeverisjes u arrit marrëveshja me kompaninë 'Pfizer' për blerjen e 1.2 milion vaksinave, kurse brenda 100 ditëve u siguruan në total mbi 2 milionë doza të vaksinave", ka thënë ai, sipas njoftimit të qeverisë.

Kryeministri Kurti ka deklaruar se Kosova është i vetmi vend në rajon që nuk ka pranuar vaksina nga Rusia ose Kina. "Kultura e re



që kemi sjellë me qeverisjen e mirë, ku korrupsioni nuk do të tolerohet, tashmë po aplikohet në praktikë. Ne duam të vazhdojmë procesin e vettingut që do ta bëjë më aktive prokurorinë tonë dhe më efikase gjyqësinë tonë", ka deklaruar Kurti.

Kurti ka folur edhe për bashkëpunimin rajonal dhe integrimin ekonomik të Ballkanit

Perëndimor.

Gjatë qëndrimit në Greqi, kryeministri Albin Kurti është takuar me ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Athinë, Geoffrey Pyatt. Në këtë takim, Kurti ka shprehur vullnetin dhe gatishmërinë e Kosovës për zgjerim të mëtejshëm të bashkëpunimit me Greqinë.

Ndërsa ambasadori amerikan ka vlerësuar angazhimin e dy shteteve për thellimin e raporteve ndërmjet tyre. Po ashtu, ata kanë biseduar edhe për avancimin e qëllimeve të përbashkëta rajonale në fushën e ekonomisë dhe tregtisë, investimeve dhe energjisë, paqes dhe sigurisë, si dhe për rrugën evropiane dhe euroatlantike të Kosovës.

Familja Bytyçi: ShBA-ja të angazhohet për zbardhjen e vrasjes së vëllezërve Bytyçi



ÇIKAGO, 9 KORRIK - Familja Bytyçi i ka bërë thirrje administratës së presidentit amerikan Joe Biden që të angazhohet seriozisht për zbardhjen e rastit të vrasjes së vëllezërve Bytyçi në Serbi më 1999. "Deri më tani ne jemi thellësisht të zhgënjyer që

administrata nuk ka ndërmarrë hapa më seriozë kur mund të bëhej kaq shumë", është thënë në deklaratën e familjes Bytyçi. Agron, Mehmet dhe Yll Bytyçi, shtetas amerikanë, me prejardhje nga Kosova, janë arrestuar në vitin 1999 në Serbi, për shkak të,

siç kanë thënë zyrtarët serbë, kalimit të paligjshëm të kufirit. Ata janë liruar nga burgu pasi janë dënuar dhe më pas janë vrarë. Trupat e tyre janë gjetur në një varr masiv pranë Petrovo Sello në lindje të Serbisë në vitin 2001. "I bëjmë thirrje

administratës së presidentit Biden që të fillojë një angazhim serioz për këtë çështje para se të jetë tepër vonë. Presidenti Biden u dha një premtim vëllezërve tanë, familjes sonë dhe komunitetit tonë. Shpresojmë që administrata e tij shpejt ta

përbushë atë premtim", është thënë në deklaratën e familjes Bytyçi.

Në këtë deklaratë është theksuar se presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq dhe Qeveria e Serbisë, vazhdimisht kanë treguar se janë aktorë jo të besueshëm në këtë çështje, "por zyrtarët e Departamentit të Shtetit refuzojnë të pranojnë këtë fakt". Baza e njëjësive speciale kundër terrorit të Ministrisë së Brendshme serbe në Petrovo Sello atëbotë ishte nën komandën e Goran Radosavleviqit-Guri. Ditë më parë Serbia nderoi me një medalje mirënjohjeje ish-komandantin e xhandarmërisë serbe, Goran Radosavleviq-Guri. Radosavleviqi është në listën e sanksioneve të ShBA-së pasi dyshohet i përfshirë në vrasjen e vëllezërve Bytyçi

Ambasada Amerikane në Serbi ka thënë më 3 korrik se Radosavleviq "duhet të përballet me drejtësinë dhe nuk duhet të marrë medalje".

Më 7 korrik Prokuroria për Krime të Luftës në Serbi ka thënë se është duke mbledhur prova të reja me qëllim që të "përcaktohet identiteti" i autorëve të vrasjes së vëllezërve Bytyçi më 1999.



OPOZITA NUK I NDAL KRITIKAT NDAJ QEVERISË KURTI

Opozita akuzon pushtetin për kapjen e institucioneve të pavarura

Partitë opozitare e kanë akuzuar qeverinë Kurti për kapje të institucioneve të pavarura. Zyrtarët e PDK-së, të AAK-së dhe të Nismës kanë thënë se me këto veprime qeveria në mënyrë arbitrare është duke i devalvuar institucionet publike dhe organet e pavarura. Ata kanë bërë me dije se do t'i kundërvihen me çdo mjet demokratik e ligjor kësaj mësymje arbitrare të pushtetit ndaj institucioneve të pavarura

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 9 KORRIK - Subjektet opozitare kanë akuzuar qeverinë Kurti për qeverisje arbitrare. Përfaqësuesit e këtyre partive kanë thënë se qeveria po i devalvon institucionet publike dhe mekanizmat e pavarur. Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, ka bërë me dije se pushteti i Albin Kurtit po shndërrohet në regjim politik arbitrar. "Pushteti i Albin Kurtit, përveçse është shndërruar në ndërmarrje për punësim familjar, për çdo ditë po shndërrohet edhe në regjim politik arbitrar, duke devalvuar institucionet publike dhe mekanizmat e pavarur. Kjo tashmë nuk është vetëm pikëpamje jona e bazuar, por edhe pikëpamje e shoqërisë civile, partnerëve strategjikë të Republikës sonë dhe çdo qytetari që po i sheh qartazi veprimet e këtij pushteti. Prandaj, ne do t'i kundërvihemi me çdo mjet demokratik e ligjor kësaj mësymje arbitrare", ka shkruar Tahiri në profilin e vet në "Facebook".

Ai ka vlerësuar se veprimet e qeverisë Kurti përbëjnë tendencë të qartë për të shembur çdo traditë të mirëfilltë institucionale. "Grupi parlamentar i PDK-së tashmë ka dërguar në Gjykatën Kushtetuese vendimin antikushtetues për shkarkimin e Komisionit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Që nga ngjizja e idesë për të ndërhyrë në këtë institucion, te vlerësimi irracional dhe veprimi arbitrar për shkarkimin e tij, siç ndodhi edhe në institucionet e tjera të pavarura, përbëjnë tendencë të qartë për të shembur çdo traditë të mirëfilltë institucionale, brutalisht e në kundërshti me ligjet e Kushtetutën. Por ne do ta ballafaqojmë këtë pushtet jo vetëm me këtë rast, por me çdo rast e shkelje që po ndërmerret me paramendim në dëm të institucioneve publike e të pavarura të shtetit tonë", ka shkruar ai.

Kritika ndaj veprimeve të qeverisë ka shprehur edhe nënkryetari i AAK-së, Muharrem Nitaj. "Nuk kam vlerësim pozitiv për punën e deritashme të kësaj

qeverie. Unë e kuptoj se situata ka qenë e rënduar edhe për shkak të pandemisë, por kjo nuk nënkupton që me veprime ose mosveprime këtë situatë ta rëndosh edhe më shumë", ka deklaruar ai. Ai ka thënë se

shkarkimi i bordeve të ndërmarrjeve publike dhe emërimi i militantëve partiakë në po të njëjtat borde, janë veprime problematike. "Ka edhe plot veprime të tjera që për mua janë problematike. Për shembull, punësimi i familjarëve në administratë dhe ndërmarrje publike; shkarkimi i bordeve të ndërmarrjeve publike dhe emërimi i militantëve partiakë në po të njëjtat borde; shkarkimi i Valdete Dakës nga KQZ-ja; qëndrimi për mbylljen e AKP-së

(Agjencia Kosovare e Privatizimit) dhe krijimi i një fondi, pa i analizuar pasojat financiare për buxhetin e shtetit; vendimi që pagesa e kartonit të gjelbër për mërgimtarë të bëhet nga taksat e qytetarëve të Kosovës; tërheqja e ambasadorëve dhe përfaqësuesve të tjerë diplomatikë pa paralajmërim dhe pa asnjë analizë; shfuqizimi i marrëveshjeve me komuna dhe heqja e mjeteve të parapara me buxhet; zvogëlimi i shumës së subvencioneve për bujq dhe subvencioneve direkte për vreshtarë", është shprehur ai.

Kurse anëtari i kryesisë i Nismës Socialdemokrate, Zafir Berisha, ka thënë se qeveria Kurti nuk po bën asnjë progres. Sipas tij, kjo qeveri do të mbahet mend vetëm për politizim të skajshëm të institucioneve të pavarura. "Kjo qeveri ka bërë vetëm vendnumërim. Nuk ka marrë ndonjë vendim që ia vlen të vlerësohet. Gjatë kësaj kohe kjo qeveri është marrë vetëm me ngarkim-shkarkime dhe politizimin ekstrem të institucioneve publike dhe bordeve. Një qeveri që do të mbahet mend për punësimin e tezeve, hallave, mbesave, nipave dhe xhaxhallarëve. Fatkeqësisht, kjo qeveri ka devijuar nga përcaktimi i Kosovës në politikën e jashtme. Kur kemi një ministër të Punëve të Jashtme që nuk po e dallon flamurin e NATO-s nga ai i OKB-së, nuk e di sa ia vlen për të diskutuar", ka deklaruar Berisha.

Ambasada e ShBA-së në Kosovë kritikon shkarkimin e bordit të RTK-së

Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë ka kritikuar Kuvendin e Kosovës për shkarkimin e bordit të Radiotelevizionit të Kosovës (RTK). Në reagimin e Ambasadës së ShBA-së është thënë se shkarkimi ka qenë i nxituar dhe i njëanshëm. "Derisa kosovarët meritojnë llogaridhënie, shkarkimet duhet të jenë të bazuara në dëshmi transparente ashtu siç

emërimet duhet të bazohen në meritë. Shkarkimet e nxituara të njëanshme dëmtojnë institucionet publike dhe nuk trajtojnë problemet strukturore. Reformat efektive afatgjata kërkojnë një qasje të qëllimshme metodike duke i lënë interesat e Kosovës të parat dhe politikën partiake", është thënë në reagimin e Ambasadës Amerikane në Prishtinë.

Specialja nuk jep arsye për moslejimin e Veselit në ceremoninë e varrimit të babait të tij

PRISHTINË, 9 KORRIK - Më 7 korrik ka ndërruar jetë Fazli Veseli, babai i ish-kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli. Në ceremoninë e varrimit të babait të tij, Kadri Veseli nuk ka marrë pjesë për shkak se gjendet në paraburgim në Hagë. Lidhur me këtë çështje, gazeta "Epoka e re" të premtën ka pyetur Gjykatën Speciale se cilat janë arsyet se pse nuk ka lejuar pjesëmarrjen e Veselit në ceremoninë e varrimit të babait të tij. Po ashtu, gazeta ka pyetur Specialen se a do ta lejojë Veselin që të vijë në Kosovë së paku për ngushëllime dhe sa a ka bërë mbrojtja e tij ndonjë kërkesë për lirim të përkohshëm. Zyra për Informim e Gjykatës

Speciale për "Epokën e re" ka thënë se paneli pranë kësaj gjykate do të vendosë për kërkesa të kësaj natyre, por nuk ka treguar nëse Veseli do të lirohet përkohësisht. "Korniza ligjore e Dhomave të Specializuara të Kosovës u mundëson personave në paraburgim që të bëjnë kërkesa te paneli kompetent (gjykatësi/t) kur ka arsye bindëse humanitare. Paneli do të vendosë për kërkesa të tilla. Të gjitha parashtimet publike të paraqitura nga mbrojtja dhe vendimet e marra nga paneli publikohen në faqen e internetit të DHSK-së", është thënë në përgjigjen me shkrim të Gjykatës Speciale dhënë gazetës "Epoka e re".

/A. MAVRAJ/



Krasniqi: BE-ja duhet ta përmbushë premtimin karshi qytetarëve të Kosovës

PRISHTINË, 9 KORRIK (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka takuar të premtën drejtoreshën për Ballkanin Perëndimor në Ministrinë e Jashtme të Gjermanisë, Susanne Schuutz dhe ambasadorin gjerman në Kosovë, Joorg Rohde, me të cilët ka diskutuar për nevojën e një perspektive të qartë euroatlantike për Kosovën. Në profilin e tij në "Facebook", ai ka shkruar se BE-ja sa më parë duhet ta përmbushë premtimin karshi qytetarëve të Kosovës. "Me drejtoreshën për Ballkanin Perëndimor në Ministrinë e Jashtme të Gjermanisë, Susanne Schutz,

dhe me ambasadorin Jorg Rohde, folëm sot për nevojën e një perspektive të qartë euroatlantike për Kosovën dhe u pajtuam se për këtë duhet një përpjekje e shtuar nga të gjithë. Gjermania është mbështetëse për liberalizimin e vizave për Kosovën dhe ne i jemi mirënjohës. Por, BE-ja sa më parë duhet ta përmbushë premtimin karshi qytetarëve tanë. Kosova beson në vlerat evropiane dhe integrimi në BE është alternativa jonë e vetme. Ne jemi të lumtur dhe krenarë që në rrugën tonë të shtetformimit, zhvillimit dhe integritimit kemi një aleat të rëndësishëm si Gjermania", ka shkruar Krasniqi.



Kryetari i PDK-së me bashkëpunëtorë shkon për ngushëllime në familjen Veseli

MITROVICË, 9 KORRIK - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka shkruar të premtën për ngushëllime në familjen e Kadri Veselit pas vdekjes së babait të tij, bacës Fazli. Në njoftimin e PDK-së është thënë se Krasniqi e ka kujtuar bacën Fazli si një simbol të rezistencës dhe një person me kontribut të pakursyer për

lirinë e Kosovës. "Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, i shoqëruar nga bashkëpunëtorë të shumtë, ka qëndruar për ngushëllime në familjen e kryetarit Kadri Veseli, pas vdekjes së babait të tij, Fazli Veseli. Krasniqi e ka kujtuar bacën Fazli njeri e baba i fortë, simbol i rezistencës, i cili i ka edukuar fëmijët e tij me frymën e

atdhedashurisë dhe patriotizmit. Dhimbjen për vdekjen e bacës Fazli e shton mosprania e kryetarit Veseli i cili po gjykohej padrejtësisht në Hagë për luftën çlirimtare. Por, kjo dhimbje shndërrohet në krenari, sepse baca Fazli do të mbahet mend për kontributin e pakursyer dhe bijve të tij për lirinë e Kosovës", ka njoftuar PDK-ja.



MAShTI synon që prej shtatorit procesi mësimor të fillojë në kushte normale

Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit (MAShTI) ka filluar përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor.

Zëvendësministrja e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit, Edona Maloku-Bërdyna, ka bërë me dije se kjo ministri pret që vitin e ri shkollor nxënësit ta vijojnë me prani fizike në objektet e shkollave

PRISHTINË, 9 KORRIK - Zëvendësministrja e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit (MAShTI), Edona Maloku-Bërdyna, ka deklaruar se kanë nisur përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor. Në një konferencë për media ajo ka thënë se ministria beson që procesin mësimor do ta nisë me prani fizike të nxënësve në objektet shkollore. "MAShTI ka nisur parapërgatitjet për një fillim sa më të mbarë. Po shpresojmë që nga shtatori procesi mësimor të fillojë në kushte normale, pra me prani

fizike. Ky proces do të varet shumë nga situata me pandeminë dhe do të vendoset nga institucionet kompetente si IKShPK-ja dhe MSh-ja. Lajmi i mirë është se ka nisur edhe vaksinimi i mësimdhënësve në mënyrë që të jemi sa më të përgatitur për vitin e ri shkollor", ka deklaruar ajo.

Ajo ka folur edhe për sfidat me të cilat procesi mësimor është përballur gjatë pandemisë. "Për shkak të situatës me Covid-19 ka qenë një vit shumë i vështirë në të gjithë sektorët, sidomos në atë të arsimit. Besoj se përmes

mësimin plotësues, të cilin e ka organizuar MAShTI për shkollat, kemi arritur që pak a shumë t'i përmirësojmë ngecjet e shkaktuara te një pjesë e nxënësve. Për sa i përket përfundimit të vitit shkollor jemi të lumtur se kemi arritur që në këtë mënyrë të ndikojmë dhe të ndihmojmë cilësinë e procesit mësimor", ka thënë ajo.

Zëvendësministrja e Arsimit ka bërë me dije se nga muaji shtator do të jenë në duart e nxënësve tekstet e reja shkollore për klasat 3, 8 dhe 12, duke shtuar se do të hyjnë në përdorim edhe tekstet alternative. Me qëllim të përmirësimit të cilësisë në arsim, ajo ka thënë se deri në fund të këtij viti do të miratohet ligji i ri për botimet e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lektyrës shkollore dhe dokumentacionit pedagogjik, pastaj do të vazhdohet me tekstet e reja për klasat e tjera. "Jemi në proces të botimit të teksteve për klasat 3, 8 dhe 12 të cilat në muajin shtator

pritet që veç të jenë në duar të nxënësve tanë. Nga viti i ardhshëm shkollor do të hyjnë në përdorim edhe tekstet alternative, pra për herë të parë do të ofrojmë mundësinë që mësimdhënësit të shfrytëzojnë të drejtën e tyre ligjore duke zgjedhur edhe tekste alternative, pastaj aprovohen e miratohen nga këshilli i shkollës. Konsiderojmë se ky është një aktivitet shtesë që ndihmon në përmirësimin e cilësisë në arsim", ka deklaruar Maloku-Bërdyna.

Ajo ka folur edhe për mbarëvajtjen e testit të maturës dhe ka bërë me dije se 15 administrues të këtij testi kanë bërë shkelje të procedurave. Sipas saj, ndaj tyre do të shqiptohen masa ndëshkimore. "Rezultati i përgjithshëm i kalueshmërisë është 68.43 për qind. Për shkak të përdorimit të telefonit nga provimi janë larguar gjithsej 69 nxënës, të cilëve u është anuluar testi. Po

ashtu, MAShTI, konkretisht Këshilli Shtetëror i Maturës, ka vlerësuar raportet e komisioneve në qendrat e testimit dhe ka konstatuar se gjithsej 15 mësimdhënës kanë bërë shkelje të procedurave të administrimit, për këtë arsye me rekomandimin e këtij këshilli të gjithë emrat e këtyre 15 administruesve do të publikohen dhe do të dënohen edhe me mjete financiare bazuar në Ligjin e maturës", ka deklaruar ajo, duke shtuar se tani janë duke bërë përgatitjet për afatin e dytë të provimit shtetëror të maturës. "MAShTI është duke bërë përpjekje dhe përgatitje që afatin e dytë të provimit shtetëror të maturës ta mbajë me kohë. Është paraparë në muajin gusht. Nxënësit të cilët në këtë afat nuk e kanë kaluar provimin e maturës do të mund të paraqesin provimin nga data 15 gusht, ndërkaq afati i dytë i provimit do të mbahet më 28 gusht", ka deklaruar Maloku-Bërdyna.



Kryetari i Gjykatës së Apelit: Pa rritje të numrit të gjyqtarëve s'mund të ketë efikasitet

PRISHTINË, 9 KORRIK (ER) - Kryetari i Gjykatës së Apelit, Hasan Shala, ka bërë me dije sa pa u rritur numri i gjyqtarëve nuk mund të ketë efikasitet në punën e kësaj gjykate. Në një konferencë për media, ku është paraqitur puna gjashtëmujore e kësaj gjykate, ai ka thënë se Këshilli Gjyqësor i Kosovës

nuk ka arritur t'i përmbushë kërkesat e Gjykatës së Apelit. Sipas tij, aktualisht kjo gjykatë ka vetëm 11 gjyqtarë. "Te lëndët e korrupsionit kemi lëndë që kanë bazën juridike korrupsion. Vitin 2020 e filluar hyrë me 20 lëndë, 39 janë pranuar në vitin 2021 deri më tani në total kemi 59, 45 lëndë janë kryer dhe 14 janë në pritje",

ka deklaruar Shala. Ai ka theksuar se për ta rritur efikasitetin e kësaj gjykate duhet të shtohet numri i gjyqtarëve. "Është rritur numri i lëndëve të zgjidhura. Është rritur në mënyrë të konsiderueshme, por jo mjaftueshëm. Pa u rritur numri i gjyqtarëve nuk mund të ketë efikasitet", ka deklaruar ai.





Shkruan: Besa ISMAILI

Sot çlirimtarët do të duhej të ishin pranë nesh dhe udhëheqës të dialogut

Nuk ka dyshim se rezistenca e armatosur e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) ka krijuar natyrën e pakapshme të idealeve tona më të dashura, përkundër asaj që vlerat e saj që dy dekada janë duke u kapur, për t'u humbur, por pa sukses.

Për historinë që e kemi shkruar së fundmi, si përpjekje shekullore për çlirim dhe lirinë, nuk kemi nevojë ta bindim askënd, sepse veprat sublime nuk interpretohen, ato jetojnë dhe assesi të rishkruhen ndonjëherë. Çlirimtarët e Kosovës që dy dekada kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë përballë dy rreziqeve të mëdha, në kohën para njëzet vjetëve, në frontet e luftës kundër Serbisë agresore, duke sakrifikuar jetët, gjymtyrët, familjet dhe

pasurinë, për një ideal të pakrahasueshëm, lirinë, e që pas saj janë duke u përballur me ideologët e transformimeve shoqërore, puthadore të sistemeve shtypëse dhe rahatllëkut institucional, që kanë mprehur lapsin tërë këto vite për të përbaltur, njollosur dhe përbuzur veprën e tyre. Këta nuk e çajnë kokën për dehumanizimin e çlirimtarëve, gjendjen e rëndë ekonomike, statusin social dhe vendimmarrjen e tyre në proceset shtetformuese. Po të ishte ndryshe mbase edhe do ta mbështetnin Ligjin për Mbrojtjen e Vlerave të Luftës të cilin kurrë nuk e bënë!

Kësaj i kontribuon edhe dehja e një establishmenti të ri ndaj

pushteti, që përdhosjen e kanë jetike përkundër çuarjes së ujit në mullirin e Serbisë, si sponsorizuesi kryesor. Nuk mund të themi se nuk kanë pasur sukses, por ky është sukses mjeranësh!

Ndërtimi i diskurseve politike të mbështjella me shpifje, akuza të pabaza për çlirimtarët ka krijuar dhe vazhdon të krijojë kushte për një tentim rishkrimi të historisë, se gjoja luftëtarët e lirisë paskan bërë krime kundër njerëzimit.

A mund të pyesim me të drejtë, se pse kjo gjykatë pretendon të hetojë krime ndaj njerëzimit në kohë dhe periudha Ushtria Çlirimtare të Kosovës (UÇK) nuk ka qenë ekzistente, siç është koha pas përfundimit të luftës, dhe mu në kohën e marrëveshjeve

ndërkombëtare me forcat e aleancës veriatlantike? Kjo është shumë e rëndësishme, sepse në rastin konkret ka shërbyer si bazë për mveshje të krimeve ndaj historisë së lavdishme të Kosovës në rrugën e saj për liri, e cila në asnjë mënyrë apo rrethanë nuk është ndërtuar mbi krime dhe vrasje të civilëve. Është ndërtuar për vetëmbrojtje dhe mbrojtjen e civilëve.

Përballja kundër kësaj situate të rëndë politike për kombin nuk njih diferencim partiak, as politik, madje as ideologjik, sepse rrezikon shtetësinë e Kosovës dhe imazhin ndërtues të saj. Kurrë më shumë sesa sot nuk na duhet uniteti për ta plasuar të vërtetën para vetes dhe para faktorit ndërkombëtar.

Sot çlirimtarët duhet të jenë pranë nesh dhe të jenë pjesë e dialogut me ata që kryen krime kundër njerëzimit dy dekada më parë, e jo Hagë dhe as në udhëtime për t'u intervistuar, as si shënjim emrash për t'u akuzuar, sepse me garanci të plotë e them, si dikush që kam përvojë 20-vjeçare në ndërtimin e paqes se asnjë proces pajtimi nuk mund dhe nuk ka sesi të rezultojë suksesshëm pa pjesëmarrjen e çlirimtarëve të cilët luftuan për liri, ndërtuan institucione dhe shtetformim si dhe janë të gatshëm edhe tash, krahas përballjes me drejtësinë, të negociojnë sypatrembur për pajtim dhe paqe të qëndrueshme në rajon. #MeÇlirimtarët #MeKosovën

“PDK-ja është unike, e hapur dhe plot energji”

PRISHTINË, 9 KORRIK (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, është takuar me kryetarët e degëve të kësaj partie për t'u organizuar për zgjedhjet lokale që pritet të

mbahen më 17 tetor. Krasniqi ka publikuar në llogarinë e vet në “Facebook” disa fotografi nga ky takim dhe ka thënë se do t'ia ofrojnë secilës komunë qeverisjen që e meriton. Në këtë kontekst, ai ka thënë se

PDK-ja është unike dhe e hapur për energji të reja. “Me kryetarët e degëve të PDK-së, për t'u organizuar sa më mirë për zgjedhjet lokale të 17 tetorit dhe për t'ua ofruar qytetarëve të secilës komunë

qeverisjen që ata e meritojnë. Për këtë, PDK është unike, e hapur dhe plot energji”, ka shkruar Krasniqi.

Javën e kaluar Memli Krasniqi është zgjedhur kryetar i ri i PDK-së.



Murati: Integrimi i të rinjve në tregun e punës, prioritet kryesor në agjendën e qeverisë

PRISHTINË, 9 KORRIK (ER) - Ministri i Financave, Punës dhe Transefereve, Hekuran Murati, ka përfaqësuar Qeverinë Kosovës në mbledhjen ministrore për punësim dhe çështje shoqërore të Ballkanit Perëndimor të organizuar nga presidenca sllovene e Këshillit të Bashkimit Evropian. Në këtë takim është diskutuar lidhur me integrimin e të

rinjve në tregun e punës, veçanërisht për skemën e punësimit të garantuar për të rinj, temë me rëndësi të lartë për Qeverinë e Kosovës. "Si qeveria e shtetit më të ri në Evropë, mirëpo edhe shtetit me popullsinë më të re, integrimi i qëndrueshëm i të rinjve në tregun e punës është prioritet kryesor në agjendën tonë të zhvillimit", ka thënë Murati. Po ashtu, ai ka ndarë

planin e tij me të pranishmit duke iu referuar tri skemave të pakos për ringjallje ekonomike të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në punësimin e të rinjve. Në këtë mbledhje, ministrat përgjegjës për punësim dhe çështje shoqërore janë takuar për të diskutuar për hapat konkretë për ndërtimin e tregjeve të qëndrueshme të punës për të rinjtë.



ATK-ja arrin që për 74.3 milionë euro ta rrisë inkasimin e të hyrave nga tatimet

Drejtori i përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Ilir Murtezaj, ka bërë me dije se për periudhën janar - qershor të këtij viti ATK-ja ka arritur që ta rrisë dukshëm inkasimin e të hyrave nga tatimet në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Ai ka thënë se rritja e të hyrave shkon deri në 74.3 milionë euro. Në këtë kontekst, Murtezaj ka thënë se ATK-ja ka tejkaluar planin e paraparë të të hyrave me 44.1 milionë euro ose 18 për qind, përderisa totali i të hyrave, sipas tij, është në 290.3 milionë euro



borxhe, përderisa në periudha të njëjta me vitin e kaluar janë inkasuar 34.5 milionë euro si efekt i pandemisë Covid-19.

Se ka pasur një trajtim të mirë dhe profesional të borxheve, sipas Murtezajt, tregojnë edhe statistikat për marrëveshjet e ATK-së me tatimpaguesit për t'i paguar borxhet me këst. "Janë 1 420 marrëveshje të cilat kanë 57.4 milionë euro borxhe të programuara, përderisa paradhënia është në vlerë 11.6 milionë euro. Edhe te kjo pjesë, nëse e krahasojmë me vitet e kaluara, vërehet se kemi dyfishin e marrëveshjeve, pasi që në vitin 2020 marrëveshje ka bërë 621 tatimpagues, me vlerë të borxhit 21.2 milion euro", ka thënë ai.

Ai ka folur edhe për procesin e faljes së ndëshkimeve, të cilat, sipas vendimit të Qeverisë të Republikës së Kosovës, numri i tatimpaguesve të cilët deri më 30 qershor kanë aplikuar për të përfituar nga ky vendim është 1 602, me mbi 8 milionë euro ndëshkime të falura, ndërsa 22.3 milionë euro tatim bazë dhe interes të paguar sipas kriterëve të vendimit.

EPOKA E RE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 9 KORRIK - Drejtori i përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Ilir Murtezaj, në një konferencë për media ka paraqitur rezultatet nga aktivitetet e zhvilluara për gjashtëmujorin e parë të këtij viti. Gjatë këtij prezantimi, Murtezaj ka thënë se ATK-ja për periudhën janar - qershor 2021 ka arritur që ta rrisë dukshëm inkasimin e të hyrave nga tatimet në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të

kaluara ku, sipas tij, rritja e të hyrave shkon deri në 74.3 milionë euro apo, shprehur në përqindje, 34.4 për qind. Ai ka treguar se ATK-ja ka tejkaluar planin e paraparë të të hyrave me 44.1 milionë euro ose 18 për qind përderisa, sipas tij, totali i të hyrave është në vlerë 290.3 milionë euro. "Pjesa e parë e 2021-s ishte periudhë e sfidave. Përkundër që kemi punuar në kohë të pandemisë janë zhvilluar reforma të ndryshme. Gjatë kësaj periudhe synim ka qenë ofrimi i shërbimeve më të mira për

tatimpaguesit. Nga të hyrat gjatë periudhës janar-qershor ATK-ja ka arritur një rekord për realizmin e objektivës, konkretisht të planit bazuar në ligjin e buxhetit, duke arritur të tejkalojë rreth 18 për qind në raport me planin dhe të tejkalojë të hyrat në vitin 2020 për rreth 74.3 milionë euro. ATK-ja është në rrugë të mirë në rritje të performancës dhe ofrimit të sigurisë për qeverinë në planifikimin e shpenzimeve buxhetore", ka thënë Ilir Murtezaj.

Fokus të veçantë në këtë konferencë nga Murtezaj ka pasur edhe trajtimi i borxheve tatimore si dhe reformat të cilat janë bërë në këtë segment. Sipas të dhënave të cilat janë shpallur para gazetarëve, reformat në mbledhjen dhe trajtimin e borxheve kanë dhënë rezultate në zvogëlimin e stokut të borxheve, ku nga mekanizmat e koncentruar në Departamentin e Mbledhjes së Detyrueshme është arritur që të inkasohen 72.9 milionë euro

Nuk miratohet në komision Projektligji për automjete

**EPOKA E RE**

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 9 KORRIK - Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor dhe Infrastrukturë ka dështuar të dërgojë në Kuvend Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për automjete, pasi deputeti i PDK-së, Bekim Haxhiu, ka lëshuar mbledhjen si rezultat i pakënaqësisë së tij për

mungesën e një dëgjimi publik. Kryetarja e komisionit, Fitore Pacolli, ka thënë se do të kërkojnë nga ministria draftimin e një ligji të ri, pasi ka shumë probleme dhe gjëra që duhet të ndryshohen. Mirëpo ishte deputeti Haxhiu që ka përsëritur disa herë kërkesën e tij që fillimisht të ketë një dëgjim publik. Ai ka deklaruar se është për heqjen e homologimit për veturat e reja, por ka theksuar se para se të miratohet një ligj

duhet të ketë dëgjim publik. Haxhiu ka thënë se ka një shpërputhje edhe në opinionin e zyrës së kryeministrit, për çfarë ka thënë se është mirë edhe për Lëvizjen Vetëvendosje të fitojë kohë, ndërkohë që merr edhe opinionet e ekspertëve. Përkundër kësaj, kryetarja e komisionit e ka hedhur në votim këtë projektligj, ndërsa deputeti Haxhiu ka lëshuar sallën, gjë që ka pamundësuar dërgimin e tij në seancën plenare.

Fakete Kadiu emërohet ushtruese e detyrës e kryeshefes në Postën e Kosovës

PRISHTINË, 9 KORRIK (ER) - Bordi i përkohshëm i drejtorëve të Postës së Kosovës në takimin e jashtëzakonshëm të mbajtur të premten ka caktuar Fakete Kadiu në pozitën e

ushtrueses së detyrës të kryeshefes ekzekutive të kësaj kompanie publike. "Deri te caktimi i u. d. znj. Fakete Kadiu ka ardhur si rezultat i dorëheqës së djeshme të parevokueshme

të ish u. d. kryeshefit ekzekutiv, z. Rafet Jashari. Znj. Fakete Kadiu i urojmë suksese dhe punë të mbarë në detyrën e re!", është thënë në komunikatën e Postës së Kosovës.

Rikujtojmë se Kadiu ishte u. d. zëvendëskryeshefe në Postën e Kosovës në kohën kur në krye të këtij institucioni ishte Vjollca Shala - Mulaj e që pastaj ishte zëvendësuar nga Etrit Hoti.



Bëhet realitet 'Bashkimi i Qytetit' në Ferizaj

FERIZAJ, 9 KORRIK (ER) - Komuna e Ferizajt, nën drejtimin e kryetarit Agim Aliu, ka përfunduar projektin "Bashkimi i Qytetit" i cili i ka dhënë një pamje të mahnitshme kësaj komune. Me këtë rast, kryetari Aliu ka falënderuar të gjithë ata që kanë kontribuar për realizimin e projektit "Bashkimi i Qytetit". Ai ka thënë se kjo vepër infrastrukturore do të ketë ndikim në zhvillimin ekonomik të Ferizajt. "Magjepsës dhe krejt i ri është tashmë trupi i qendrës së Ferizajt. Asgjë nuk na ndal kur jemi bashkë e të vendosur. Guximi, vizioni, dija dhe këmbëngulja, triumfoi që sot të shkëlqejë kjo kryevepër infrastrukturore. Me nënkallimet në Varosh - Nikadin, te 'Plus Market'-i dhe nënkallimi në rrugën 'Vëllezërit Gërvalla' që sot

përruam, i thamë përherë lamtumirë pasigurisë nga hekurudha, duke i dhënë mundësi ekonomisë në këtë zonë, lëvizshmërisë së lirë të qytetarëve të çdo moshe e patjetër një identiteti që krijon kjo vepër madhështore në zemrën e Ferizajt. Dua nga zemra t'u themi të gjithëve, që vendosën qoftë edhe një gozhdë në këtë projekt, që thanë një fjalë në krahun e paskajë të mbështetjes qytetare, duartartëve që kthyen ëndrrën në realitet, faleminderit! Ta gëzojnë ferizajasit e sotëm dhe ata që do të vijnë pas nesh, ta shijojmë të bukurën e perfeksionin infrastrukturor në damarët e zemrës së qytetit. Urime Ferizaj 'bashkimi i qytetit', kjo vepër që trashëgim po ua lëmë brezave!", ka thënë Aliu.



Gjilani fton shërbyesit civilë, zyrtarët publikë dhe punëtorët e arsimit të aplikojnë për vaksinim



GJILAN, 9 KORRIK 2021 - Komuna e Gjilanit ka ftuar shërbyesit civilë, zyrtarët publikë dhe punëtorët e arsimit që të aplikojnë për vaksinim kundër Covidit përmes platformës "e-Kosova" apo në mënyrë të organizuar përmes Qendrës së Vaksinimit e cila gjendet në palestrën e sporteve "Bashkim Selishta - Petriti" në Gjilan. Kjo komunë ka bërë me dije se ka angazhuar 15 ekipe për procesin e vaksinimit i cili është duke ndodhur sipas rregullave për ta parandaluar fluksin. "Deri tani në Gjilan janë

vaksinuar mbi 12 mijë qytetarë, ose rreth 15 për qind e qytetarëve. Terminë për vaksinim përmes platformës 'e-Kosova' mund të caktojë edhe kategoria e qytetarëve e moshës mbi 40 vjeçe", ka njoftuar Komuna e Gjilanit. Ndërsa kryetari i kësaj komune, Lutfi Haziri, pas mbledhjes së Komitetit për menaxhimin dhe parandalimin e përhapjes së Covid-19, u ka bërë thirrje qytetarëve që të vazhdojnë të vaksinohen, pasi është e vetmja mënyrë për t'u mbrojtur nga ky

virus. Haziri ka bërë me dije se ai dhe anëtarët e shtabit të emergjencave janë të parët që janë vaksinuar me "AstraZeneca". "Unë dhe anëtarët e komitetit jemi të parët që jemi vaksinuar me 'AstraZeneca'. Është vaksinë e sigurt dhe mos u besoni teorive konspirative. Deri tani mbi 12 mijë gjilanas janë vaksinuar dhe i ftoj edhe të tjerët që të aplikojnë dhe ta marrin vaksinën. Është e vetmja mënyrë për t'u mbrojtur nga ky virus", ka thënë Haziri.

Bulliqi nënshkruan dy memorandume bashkëpunimi me "Qatar Charity"

PODUJEVË, 9 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi dhe drejtori i përgjithshëm i organizatës "Qatar Charity", Mahmoud Abbas, kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi për hapjen e 55 puseve të reja dhe grante të ndryshme në fushën e bujqësisë. Po ashtu, ata kanë nënshkruar edhe nënshkrimin për grante në fushën e bujqësisë duke përfshirë primëkulturrë, mekanizëm bujqësor, bagëti dhe shoqëri bletësh. Nga ky memorandum Komuna e Podujevës do të participojë me 10 për qind të koston të projektit e pjesën tjetër do ta financojë organizata "Qatar Charity". Me këtë rast, kryetari Bulliqi është zotuar për bashkëpunim të mëtejshëm me këtë organizatë, të cilën e ka

falënderuar për kontributin e vazhdueshëm në komunën e Podujevës. "I falënderova përfaqësuesit e kësaj organizate për kontributin e vazhdueshëm në komunën tonë dhe shprehja gatishmërinë e plotë për të bashkëpunuar edhe në projekte të tjera në interes të qytetarëve llapjanë. Para tyre paraqita disa prej projekteve për të cilat ka nevojë komuna e Podujevës, duke vlerësuar lart bashkëpunimin e ndërsjellët. U pajtuam të vazhdojmë projektet e tjera në dobi të Podujevës", ka thënë Bulliqi. Kryetari Bulliqi në fund të ceremonisë nënshkruese ka ndarë nga një mirënjohje dhe nga një dhuratë modeste për drejtorin Abbas dhe menaxherin kryesor të projekteve, Khalid Abdulla MH Alayfei.



Klithma e Kosovës



Nga: Luan RAMA

Kjo fotografi e fotografit francez Georges Merillon, që nga dita kur mori çmimin e fotografisë më të mirë të "World Photo Presse" më 1991, ajo u bë e njohur në të gjithë botën si dhe objekt i shumë analizave estetike, edhe pse vetë fotografia nuk kishte asnjë simbol apo semiologji politike, madje as "pieta", siç e cilësuan jo pak kritikë këtë fotografi: "Pieta du Kosova". Vallë një ndjesi mëshire për një nënë apo familje që qan birin e saj, atje, në dyshemenë e zbrazët të asaj shtëpie të thjeshtë, në shtëpinë ku ajo kishte lindur pjellën e vet? Nëna është aty, rrethuar nga vajzat, nusja, njerëzit e afërt të familjes, në qendër të atij grumbulli njerëzor të ngërthyer nga dhimbja e ku përpara, si në prehrin e saj ka birin e vdekur. Dhe ajo klith.

Është kjo klithmë kundër vdekjes që e kapërcen përkufizimin që disa kritikë i dhanë kësaj fotografie dhe duke risjellë në memorien kolektive veprat e njohura "Pieta" e Mikelanxhelos e vitit 1499, "Pieta" e Van Dyck e 1624, apo atë tablo madhështore të Caravaggios e pikturuar më 1606, ku qahet një i vdekur, apo Shën Marinë në kokën e Jezusë së vdekur. Madje, po atë vit, kur një gazetar e pyeti presidentin

Mitterand të komentonte një nga fotografitë më emblematike të vitit, ai komentoi pikërisht këtë foto të botuar në dy faqet e "Figaro magazine", duke thënë ndër të tjera: "E shikon atë fotografi dhe nuk ke si të mos mendosh për një tablo të Mantegnas apo Rembrandtit... zemërimi dhe dhimbja kanë gjithnjë të njëjtën fytyrë!..".

Tablotë pa dyshim janë emblematike dhe kanë mbetur në historinë e artit, e ndoshta dikush mund ta krahasonte dhe me "Klithmën" e Munchut, çka më duket më afër, por përsëri, në strukturën e saj, në raportet e dritë-hijes dhe për më tepër në atë thjeshtësi të zymtë kuadri pa asnjë artifis, me atë lloj drite qumështi, nga bryma e asaj dite të ftohtë dimri, e mbajtur në ekspozim në një shpejtësi 20-30 sekonda, kjo tablo qëndron e jashtëzakonshme dhe e tejkalon idenë e "Pieta"... Ne nuk mëshirojmë atë nënë për djalin e saj, ne tronditemi gjer në thellësinë e ndjesive tona me atë klithje që ka mbetur ngjizur në ato buzë, në atë skenë të fotografuar brenda një çasti të shkurtër, papritur, pa i thënë askujt, pasi fotografi Merillon qëndroi në atë dhomë mortu, ku qëndrojnë sipas traditës vetëm gratë, veçse dy-tre minuta, jo më shumë. Ndoshta Merillon nuk e imagjinonte që në "dhomën e

errët" të aparatit të tij të ishte regjistruar një nga fotografitë më kulmore në jetën e tij si artist. Jo, nuk ishte "Pieta", por një klithmë sa personale aq dhe e një populli. "Klithma e Kosovës".

Vite më vonë, kur gazetarja franceze Annick Cojean, e kishte parë këtë foto dhe do shkruante një libër rreth 13 fotografive emblematike të botës, mes të cilave një e Hiroshimës, një tjetër e princshës Diana, një e revolucionit feminist apo kundër dallimit racial, midis tyre ajo zgjodhi dhe këtë fotografi, për të parë me sytë e saj vendin e ngjarjes dhe rikrijuar edhe njëherë tablonë e kohës. Bëhej fjalë për shkrimin e librit "Kthimi tek imazhet". Dhe ajo u nis drejt fshatit kosovar ku kishte ndodhur kjo ngjarje tronditëse. Me makinë kishte rrahur rrugët e Kosovës mbushur me policët e Milosheviqit. Dhe gazetarja e "Le Monde" shkoi gjer në Rahovec, në fshatin Nagafc, ku Nasimi ishte vrarë më 29 janar të vitit 1990. Ishte vrarë në një pritë të policisë, kur bashkë me disa shokë po shkonin për të marrë pjesë në një manifestim, pa armë, vetëm me një copë flamur. Dhe, ata i kishin vrarë ata katër të rinj të lirisë duke plagosur dhe 32 të tjerë... Në Rahovec ajo takoi nënën e Nesimit, atë që vuri atë kuje epike. Ajo i tha se "Nesimi ishte i bukur, i fortë... se kështu

Nesimi jeton sërish, dhe emri i tij mbush jetën e këtyre njerëzve"... "Në prag të martesës së tij, – i thoshte ajo, – ai manifestonte në Prishtinë për Kosovën dhe unë kisha frikë". Por atë ditë të akullt janari, kur Sabrija, nëna e tij kishte parë atë grup njerëzish t'i afroreshin shtëpisë së saj, me ato fytyra në zi, me atë vështrim të heshtur e gjithë tmerr, ajo e kuptoi se vdekja e kishte marrë Nesimin. Dhe ajo ulëriu: "Oh, e mjera nanë, e mjera nanë që sheh birin e saj të vdekur! Si mund të hysh kështu biri im në shtëpinë tënde?..." Dhe, atë e kishin futur ashtu të vrarë, duke e vendosur në mes të dhomës, ashtu siç do ta gjente pak çaste më vonë fotografi i GAMA-s Georges Merillon, që me të marrë vesh ngjarjen ishte nisur nga Prishtina. Katër orë rrugë me makinë për të pikëtakuar vdekjen...

Në bisedë me gazetaren e "Le monde", motra më e vogël, Afërdita Elshani, i tregonte: "Një mbrëmje më parë isha shqetësuar kur vëllai im u kthye vonë nga mbledhja. Por, e dija se çështja e Kosovës ishte thellë zemrës së tij. Një mëngjes unë e pyeta: "Do ta fitojmë dot lirinë, apo jo?" Dhe ai më buzëqeshi ëmbël: "Së shpejti!" E përçolla deri tek porta. Nxitonte përsëri në një tjetër manifestim dhe thashë me vete se kam një vëlla te

mrekullueshëm. Më kujtohet se kur isha shtatë vjeçe, njerëzit e shtëpisë e përçollën me rastin e nisjes së tij ushtar. Por, papritur policia serbe rrethoi shtëpinë duke kontrolluar kudo për të gjetur materiale propagandistike. Nasimi kishte frikë se mos thyenin gjithçka. "Mjaft! – u thirri më në fund. Dhe ai u dha disa kaseta e trakte ku shkruhej 'Kosova Republikë'. E arrestuan menjëherë. Por, nuk kisha frikë. Isha shumë krenare që kisha një vëlla të tillë... Dhe ata e vranë. Përse? Ai ishte i drejtë, kurajoz dhe mbronte popullin e tij. Ja, tashmë në gjirin e familjes, i zbehtë, pa jetë, me fytyrën e tij të bukur dhe flamurin e vogël të Kosovës nën mjekër që i vuri gruaja e tij. Nuk mund të kesh një vëlla më të mirë. Dhe nuk mund të ketë vdekje më të bukur se ajo për lirinë..."

Që nga ajo shkrepje e aparatit të Merillon kanë kaluar 18 vjet dhe kjo fotografi mbetet një embleme për Kosovën. Një lloj ikone në historinë e fotografisë. Mjafton ta shohësh gjatë atë për të kuptuar semiologjinë e një historie të tërë. Britma e saj ka një emër: "Kurrë më!" Por, fotografia ka një dimension edhe më universal: është humaniteti i përballur me barbarinë, vdekjen! Ja pse kjo "Pieta-britmë" mbetet një referencë e gjallë për kohërat që vijnë.

Pushkini: Jeta në kohë epidemie

Në prag të kolerës, në korrik 1831, Pletnirov i shkruante Pushkinin për vdekjen e plakut Mollçanov, me të cilin ishte i lidhur shumë. Edhe Pushkini po kalonte kohë të vështira; ai ende vajtonte për Delvigun, shokun e Liceut dhe mikun e tij shpirtëror. Ai i kishte 32 vjet. Dhe ja fjalët e ngushëllimit që gjeti Pushkini.

PLETNIROVIT

22 korrik 1831, Carskoe Sello

... Letra jote e dates 19 më ka brengosur fort. Përsëri po mërzhitesh. Ej, pa shiko: mërzhia është më e keqe se kolera, njëra vret vetëm trupin, tjetra shpirtin. Delvigu vdiq. Molçanovi vdiq; prit, do të vdesë dhe Zhukovskij, do të vdesim dhe ne. Por jeta gjithsesi është e pasur; do të takojmë të njohur të rinj, këta të rinj do të na bëhen miq, bija jote do të rritet, do të bëhet nuse, ne do të bëhemi pleq gërmuqë dhe gratë tona plaka gërmuqë, por të vegjëlit do të bëhen fëmijë të dashur, të mbarë, të qeshur; djemtë do të bëhen çapkëne kurse vashat sentimentale; neve na bëhet shumë mirë. Gjepura, shpirti im; mos u mërzhit-kolera vjen dita dhe shkon, të mbetemi edhe ne gjallë, do të jemi si dikur dhe të gëzuar...

Më vjen keq që nuk i ke marrë

letrat e mia. Kishte mes tyre serioze; por nuk është hatá. Eslingu, ai të cilin ti e njeh,- nip im i Liceut dhe, duket një djalë i mbarë- e porosita që të dorëzonte "Përrallat e mia"; lexoi ato për hir të mërzhisë nga kolera, nuk ka ngut për t'i botuar. Përveç 2000 për "Borisin", s'kam marrë asgjë nga Smirdini; besoj, janë mbledhur afërsisht po dy mijë nga rroga; shkruaji atij që të m'i dërgojë me postë, duke të lënë ty 500. Me që ra fjala po të tregoj një lajm (por të mbetet, për shumë arsye, midis nesh): cari më ka marrë në shërbim - por jo në kancelari, apo pranë oborrit, apo në ushtri-jo, ai më ka dhënë rrogë, më ka hapur arkivat, që të gërmoj atje dhe të mos bëj asgjë. Një mirësi shumë e madhe nga ana e tij, apo jo? Ai tha: "Puisqu'il est marié et qu'il n'est pas riche,



il faut faire aller sa marmite." [Me që është i martuar dhe jo i pasur, i duhen dhënë mjete për të jetuar.] Me të vërtetë që është treguar shumë i mirë me mua. Po kur do të shihemi, vëlla? Oh, kjo kolera tani! Jusupovi im vdiq, Hvastovi ynë vdiq. Me shpresë se vdekja do të kënaqet vetëm me ato dy viktima. Lamtumirë. Shumë të fala. Qofshi me shëndet. Krishti me ju.

PO CILI ISHTE PLETNIROVI

Pjotr Aleksandroviç Pletnirov

është një nga poetët e shumtë të kohës së Pushkinin, kritik dhe botues. Gjithashtu, mik i Pushkinin dhe ndihmësi i parë e tij në çështjet letrare. Ato u njohën shumë kohë para se Pushkini të përfundonte Liceun. Letërkëmbimi i tyre është përplot me çështje letrare, botimi, financimi, praktike dhe çdo gjë tjetër. Ai ishte për Pushkinin "gjithçka: dhe i afërm, dhe mik, dhe botues, dhe arkëtar". Ai nxori në dritë- që do të thotë gjeti botues dhe librashitës, zgjidhi çështjet

tipografike, materiale dhe probleme të tjera, për më shumë se 20 libra të tij. Dhe të gjitha këto pa asnjë interes. Pushkini e quante Pletnirovin "mëndeshë", "bamiresh" dhe e pranonte që për pavarësinë e tij "i detyrohem Zotit dhe ty". Si akt mirënjohjeje nga ana e tij, Pushkini i kushtoi Pletnirovit kreun IV dhe V të romanit në vargje "Eugjen Onjegini" [1828] dhe më vonë- të gjithë romanin [në 1833, kur doli botim i veçantë.] *exlibris.al*

Përgatiti dhe përktheu B. Hudhri



Eugjen Onjegini



Pjotr Aleksandroviç Pletnirov



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Superliga fillon më 28 gusht, Prishtina nis mbrojtjen e titullit ndaj Malishevës



SUPERLIGA - Java e parë

Drita - Feronikeli
Llapi - Ulpiana
Malisheva - Prishtina
Ballkani - Dukagjini
Drenica - Gjilani

LIGA E PARË - Grupi A - Java e Parë

Trepça '89 - Liria
A&N - Drenasi
Rahoveci - Besa
Onix - Vëllaznimi
Istogu - Trepça

LIGA E PARË - Grupi B - Java e Parë

Ferizaj - Vllaznia
Ramiz Sadiku - 2 Korriku
Fushë Kosova - Kika
Dardana - Vitia
Arbëria - Flamurtari

PRISHTINË, 9 KORRIK (ER) - Edicioni i ri në Superligën e Kosovës në futboll do të fillojë më 21 gusht, kurse në Ligën e Parë më 28 gusht. Shorti për edicionin e ri është tërhequr të premtën në ambientet e stadiumit "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Fillimisht u tërhoq shorti për Superligë, më pas edhe për Ligën e Parë në të dyja grupet. Të pranishmit në emër të KE të FFK-së dhe Komisionit të Garave i ka përshëndetur kryetari i këtij komisioni, Abdyl Bellopoja, i cili i uroi klubet për një kampionat të suksesshëm si dhe i njoftoi përfaqësuesit e klubeve për

procedurat e shortit. Kampionia në fuqi, Prishtina, në ndeshjen e parë do të përballet me skuadrën e promovuar në elitë, Malishevën. Ndërsa fituesi i Kupës, Llapi, në ndeshjen e parë e pret skuadrën tjetër të inkuadruar në Superligë, Ulpianën. Nënkampionia e Kosovës, Drita, përballet me Feronikelin, ndërsa Gjilani i Ismet Munishit në xhiron e parë ka punë me Drenicën në Skenderaj. Ndeshja e pestë është ajo në mes të Ballkanit dhe Dukagjinit. Derbi më i madh në Superligë mes Dritës dhe Gjilanit zhvillohet në javën e gjashtë.

SHKURT

Kuipers do të vendosë drejtësi në finalen Itali - Angli

UEFA ka përcaktuar gjyqtarët që do të vendosin drejtësi të dielën në finalen e Evropianit në mes të Italisë dhe Anglisë. Gjyqtar kryesor do të jetë holandezi Bjorn Kuipers. Për 48-vjeçarin do të jetë sfida e katërt që do të gjykojë në këtë Evropian, pas dy sfidave të gjykuara në fazën e grupeve Danimarkë - Belgjikë dhe Sllovaki - Spanjë dhe çerekfinale ndërmjet Çekisë dhe Danimarkës. Holandezi është prej vitit 2006 në listën e FIFA-s dhe prej vitit 2009 në listën e UEFA-s. Ndihmës të Kuipers do të jenë dyshja tjetër holandeze Sander Van Roekel dhe Erëin Zeinstra ndërsa gjyqtar i katërt është zgjedhur spanjoli Carlos Del Cerro Grande. Në VAR do të jetë një gjerman, Bastian Dankert. Finalja do të luhet në orën 21:00 në stadiumin "Wembley".

Çmime marramendëse të biletave për finalen e 'Euro 2020'

Biletat në internet për të parë ndeshjen e Anglisë kundër Italisë në finalen e "Euro 2020" në "Wembley" po shiten me çmim prej 17 500 eurosh. Biletat e shumëkërkuara fillimisht ishin në dispozicion përmes portalit të biletave UEFA, që kushtonin midis 94 dhe 940 eurosh, por ato tani janë shitur të gjitha. Tani shitësit po kërkojnë të fitojnë deri në 1 800 për çind fitim, raporton Evening Standard. Një ofertë në eBay ishte çmimi prej 70 mijë eurosh për katër bileta në vendin e njëjtë. Një shitës tjetër donte të merrte 14 500 euro për dy bileta dhe një tjetër kërkoi 4 mijë euro për një biletë.

Carragheri: Anglia fiton pas penalltive

Ish-mbrojtësi i Liverpoolit dhe Kombëtares së Anglisë, Jamie Carragher, ka bërë parashikimin e finales së "Euro 2020" mes Anglisë dhe Italisë. "Mendoj se do të jetë një finale shumë e luftuar. Besoj se do të shkojë me penallti dhe aty do të fitojë Anglia. Skuadra ka punuar shumë me penalltitë dhe duhet të vërë në praktikë gjithçka ka mësuar. Në çdo rast, nuk mendoj se gjatë ndeshjes do të ketë shumë gola. Italia është shumë e fortë në fazën mbrojtëse. Besoj se ndeshja do të përfundojë 1-1 dhe pastaj do të jenë penalltitë që do të vendosin. Mendoj se është finalja e duhur për këtë turne. Kanë qenë dy skuadrat më të mira. Të dielën do të ketë spektakël", ka deklaruar Carragher.

Ukaj: Grup i vështirë, por do të japim më të mirën tonë

PRISHTINË, 9 KORRIK - Kosova U20 te femrat nuk do ta ketë aspak lehtë në U20 Women's European Challengers që do të organizohet në Shkup prej 13 deri më 18 korrik 2021. Kosova do të luajë në grup me Rumaninë, Sllovakinë, Luksemburgun dhe

Maqedoninë e Veriut. Sidoqoftë, basketbollistet e Kosovës U20 kanë stërvitur maksimalisht dhe shpresojnë në paraqitje pozitive. Një ndër to është edhe Tringa Ukaj. "Përgatitjet kanë shkuar shumë mirë dhe kemi dhënë më të mirën

tonë në mënyrë që të jemi të gatshme për garat që na presin", është shprehur Ukaj për faqen zyrtare të FBK-së. 20-vjeçarja së fundi u transferua në Suedi, duke qenë pjesë e skuadrës Hogsbo Basket, kurse në Kosovë fitoi titullin me

Penzën dhe me AA Kerasan Prishtinën fitoi Kupën e Ligës së Parë. "Shpresojmë se do të bëjmë paraqitje sa më të mira në Shkup. Angazhimi nuk do të mungojë. Edhe pse nuk do ta kemi aspak lehtë, do ta japim maksimumin në këto sfida", ka shtuar Ukaj.



Befason Mavraj, transferohet në Liga 3 të Gjermanisë

MUNCHEN, 9 KORRIK - Mërgim Mavraj, pas përvojës me Greuther Furth në Bundesliga 2, tashmë ka gjetur klubin e ri dhe do të luajë në Liga 3 në Gjermani. Qendërmbrojtësi, i cili ka mbajtur edhe shiritin e kapitenit me Shqipërinë dhe ka

qenë në "EURO 2016" me kuqezinjtë, është zyrtarizuar te Turgucu Munchen. "Mërgimi është një lojtar me përvojë dhe cilësitë e tij do të na ndihmojnë. Ai është një mbrojtës pozicional, është i fortë në lojën në ajër dhe bën një hapje të mirë të lojës.

Mërgimi, gjithashtu, ka një personalitet të fortë dhe për këtë arsye do të luajë një rol të rëndësishëm në ekipin tonë", ka thënë drejtori sportiv i Turgucu Munchen, Roman Plesche. Ndërsa Mërgim Mavraj ka deklaruar: "Në këtë klub vë re

shumë gjëra që kanë dalluar dhe kanë formuar karrierën time. Mund të zgjidhja ndonjë rrugë më të lehtë, por nuk më pëlqen t'i bie shkurt ashtu sikurse edhe Turgucu Munchen nuk i pëlqen të gjejë rrugën e lehtë. Do të punojmë së bashku si



komunitet për të arritur të suksesi".

Chiellini: Që tre vjet ëndërrojme këtë çast

LONDËR, 9 KORRIK - Giorgio Chiellini e pranon se ai mendonte se Roberto Mançini ishte 'i çmendur' kur foli për fitimin e "Euro 2020" nga Italia, ndërsa shtoi se pret një finale të shkëlqyeshme ndaj një skuadre të fortë siç është Anglia. Finalja e madhe mes Anglisë dhe Italisë zhvillohet të dielën në "Wembley" nga ora 21:00. "Është një ëndërr që ne e kultivim për tre vjet dhe trajneri na e shpoi në kokë derisa u bë realitet. Kur ai na tha në fillim të mendonim për të fituar 'Euro 2020', ne menduam se ai ishte i çmendur. Megjithatë, jemi pikërisht atje dhe vetëm një centimetër larg trofeut", ka thënë Chiellini.

Italia kishte një rrugë shumë të vështirë për në finale, megjithëse jo aq sa e priste mbrojtësi Chiellini. "Ne menduam se do të përballëshim me Francën në vend të Spanjës në gjysmëfinale, pasi ata ishin favoritët e mëdhenj, ata kishin të gjithë cilësinë e nevojshme dhe përvojën ndërkombëtare. Mendova se Franca ishte një hap mbi pjesën tjetër, kështu që kisha supozuar se rruga jonë drejt finale do të ishte Belgjika, Franca dhe Anglia", ka shtuar mbrojtësi italian. Chiellini më pas tregon pse ka besuar se anglezët do të jenë në finale të



Kampionatit Evropian. "Unë menjëherë mendova se Anglia do të ishte një kandidat serioze për të fituar 'Euro 2020'. Ajo ka cilësi dhe fizik, është solide dhe e organizuar, mund të mos jetë e lehtë për syrin, por është e vështirë për t'u mposhtur. Lojtarët e saj ata arritën në gjysmëfinale në Kupën e Botës, plus ishte e parashikueshme që Anglia do të ishte në finalen e Evropianit, pasi luajti gjashtë nga shtatë ndeshjet në terrenin vendas", ka shtuar ai.

Chiellini e ka lavdëruar edhe sulmuesin Harry Kane, por edhe lojtarët e tjerë ofensivë: "Kane është një lojtar që më ka

pëlqyer gjithmonë shumë. Mbjaj mend një nga ndeshjet e tij të para në Torino dhe ai menjëherë më bëri një përshtypje të mirë. Ne kemi pasur fatin të luajmë kundër Tottenhamit, kështu që unë e njoh atë mirë. Anglia nuk është vetëm Kane, pasi ka lojtarë të jashtëzakonshëm që sulmojnë nga krahët. Vetëm stoli i saj mund të fitojë Euron, pasi aty janë Jack Grealish, Jadon Sancho, Marcus Rashford, Dominic Calvert-Lewin dhe Phil Foden. Do të jetë një lojë e shkëlqyeshme e futbollit. Asnjëra skuadër nuk do të ketë frikë dhe të dyja do ta respektojnë njëra-tjetrin".

Phoenixi fiton edhe finalen e dytë

PHOENIX, 9 KORRIK - Phoenix Suns fiton edhe finalen e dytë ndaj Milwaukee Bucksit dhe tashmë vetëm dy suksese larg vendosjes së unazës së kampionit në NBA. Në Arizona paraqitja mbresëlënëse e grekut Giannis Antetokounmpo, autor i 42 pikëve dhe 12 rebound-eve dhe 4 asistimeve, nuk i mjaftoi Milwaukee që u mposht me rezultatin 118-108 nga skuadra e trajnerit Monty Williams. Më të mirët mbi parket për Phoenixin ishin Davon Booker dhe Mikal Bridges, me të parin që koleksionoi në total 31 pikë, 5 rebounde dhe 6 asistime, ndërkohë që Mikali Bridges realizoi 27 pikë. Paraqitje pozitive edhe ajo e Chris Paulit 23 pikë, 4 rikuperime poshtë tabelës dhe 8 pasime decizive. Phoenixi nuk e nisi shumë mirë sfidën me periodën e parë që u mbyll me avantazhin e 3 pikëve në favor të skuadrës së trajnerit Mike Budenholzer, por perioda që vendosi sfidën ishte pikërisht e dyta. Suns u



tregua shumë më i lartë në këtë fraksion loje duke realizuar 14 pikë më shumë se Bucksit. E baraspeshuar ishte edhe pjesa e dytë me Milwaukee që realizoi vetëm një pikë më shumë në periodat 3 dhe 4, por në fund u dorëzua me rezultatin 118-108. Te Bucksit u ndje performanca e dobët e Khris Middletonit i cili realizoi në total vetëm

11 pikë, teksa pikëshënuesi i dytë më i mirë i skuadrës pas Giannis Antetokounmpo ishte Holiday me 17 pikë. Tashmë seria e finaleve të mëdha të NBA-s do të zhvendoset në Wisconsin, aty ku Bucksit, në dy ndeshjet e radhës, do të tentojë përpara publikut ta barazojë në 2-2 serinë ndaj Phoenixit.

SHKURT

Arsim e Erdoan Vitaku ndajnë drejtësinë në Evropianin në Slloveni

Gjyqtarët e Federatës së Hendbollit të Kosovës vazhdojnë ta fitojnë besimin e Federatës Evropiane (EHF). Dy gjyqtarët mitrovicas, Arsim e Erdoan Vitaku, janë deleguar për ta ndarë drejtësinë në Kampionatin Evropian U19 për hendbolliste që të enjten filloi në Celje të Sllovenisë. Për çiftin Vitaku është hera e pestë rresht që drejton ndeshje në Kampionate Evropiane. Evropiani në Celje mbahet deri më 18 korrik. Po marrin pjesë 15 ekipe kombëtare, ndërsa që në ditën e parë ka pasur ndeshje interesante. Gjyqtarë të tjerë të FHK-së janë deleguar për kampionate kontinentale të grupmoshave që mbahen këtë verë.

Schumacheri: Po përmirësohem nga gara në garë

"Mendoj se pas çdo gare po përmirësohem më gjithë, unë si pilot dhe makina", u shpreh 21-vjeçari Mick Schumacher, piloti i Hass në Formula 1. Djali i Michael Schumacherit debutoi këtë sezon në Formula 1 dhe shprehet i kënaqur me ecurinë. "Ndiej se po bëhem më i fortë nga gara në garë. Kur kaloj më shumë kohë me skuadrën është një armë më shumë për mua, më argëtuese. Mezi pres garën e radhës në Silverstone për të synuar një rezultat edhe më të mirë se në Austri", ka thënë Mick Schumacher. Edhe drejtori sportiv i Haas, Guenther Steiner, mendon pozitivisht për pilotin e ri gjerman: "Faza e përshtatjes dhe e rritjes nga gara në garë po ecën mirë. Të dy, Mick e Nikita, po ecin mirë, po përmirësohen. Për fat të keq, nuk u japim dot një makinë më të shpejtë".

Giroudi përforcon Milanin

AC Milan është përforcuar për sezonin e ri me një sulmues. Kuqezinjtë kanë mbyllur me sukses operacionin Olivier Giroud për të cilin prej kohësh drejtori sportiv, Maldini, kishte insistuar për ta afruar. Edhe pse Chelsea ia zgjati kontratën me një vit, Milani ofroi një milion euro plus 1 milion euro të tjera bonus për ta bindur klubin anglez ta linte të lirë. Giroudi do të firmosë për dy sezone me kuqezinjtë dhe do të përfitojë 3.5 milionë euro në vit.

Mjekët e PSG-së për Ramosin: Fizikisht është si një 25-vjeçar

Sergio Ramos është futbollist më i ri i ekipit francez, PSG. Mjekët e klubit francez janë marrë me Ramosin pesë orë gjatë testeve mjekësore dhe përfundimi ka qenë se ish-kapiteni i Realit është në gjendje fizike si një 25-vjeçar. Spanjoli ka nënshkruar për dy vjet dhe rroga e tij do të jetë shumë e lartë, deri në 15 milionë euro në një sezon.

Fury, pozitiv me Covid, shtyhet dueli ndaj Wilderit

Boksieri britanik Tyson Fury, kampion bote në peshën e rëndë (kategoria WBC), ka dalë pozitiv me Covid-19. Bashkë me të, pozitiv me koronavirus kanë

rezultuar edhe disa anëtarë të stafit me të cilët po kryen fazën përgatitore. Për pasojë, dueli i 24 korrikut ndaj amerikanit Deontay Wilder do të shtyhet

edhe pse ende nuk ka një njoftim zyrtar për këtë gjë. Tyson Fury është vaksinuar, por ai ka marrë vetëm një dozë. Kompania që menaxhon Fury, "Top Rank", u

shpreh se është duke monitoruar gjendjen e boksierit të pamposhtur britanik dhe të stafit. Një ngjarje që ka përmbytur sërish situatën në peshën e

rëndë. Sipas mediave amerikane, pritet që dueli mes Furyt dhe Wilderit të zhvillohet në tetor të këtij viti, por ende nuk ka asgjë zyrtare.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania “Caja Company” Sh.p.k. Dragobil, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për projektin e pompës së derivateve dhe restaurant në Dragobil, Malishevë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 30.07.2021 në ora 09:00 në zyret e Kompanisë “Caja Company”- Dragobil do të organizohet debat publik nga Kompania “Caja Company” Sh.p.k. Dragobil, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për projektin e pompës së derivateve dhe restaurant në Dragobil, Malishevë.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

Linku:

<https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=b252S1MvQmphd1o3bW8vckxadVorQT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së “Caja Company” Sh.p.k. Dragobil

https://mea.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania “Petrol Compant”, Sh.p.k.Mazgit, Prishtinë, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e karburanteve në Trudë, Prishtinë

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 30.07.2021 në ora 10:00 në restaurantin RIDA, adresa: segmenti rrugor Prishtine – Podujeve, ne anen e djatht, afer udhekryqit qe bëhet degezimi ne mes te tranzitit Podujeve – Mitrovice, afer NEXT MARKETIT, fshati Besi do të organizohet debat publik nga Kompania “Petrol Compant”, Sh.p.k.Mazgit, Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e karburanteve në Trudë, Prishtinë
Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

Join Zoom Meeting

www.zoom.us/j/6288263177?pwd=SkNGTWZCN2ZDakQxd09nYzhpZ3gxZz09


Meeting ID: 628 826 3177

Passcode: 6N39Pv

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë “Petrol Compant”, Sh.p.k.Mazgit, Prishtinë, për stacionin e karburanteve në Trudë, Prishtinë.

https://mea.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpeite

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ “3 MIX” SH.P.K. me nr. 810774655 bënë zvogëlim të kapitalit nga 950.000.00 në 5.000.00.
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

